



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 307, datë 13.07.2021**

**PËR**  
**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES SË PUNËS SË ZNJ. {...} NË POZICIONIN E**  
**KANCELARES SË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË VLORË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 38, 55, 56 dhe 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pikat 18 dhe 25, seksioni C, kreu IV dhe pikën 122, seksioni A, kreu XI të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, znj. Brikena Ukperaj,

**VENDOSI:**

1. Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së znj. {...}, në funksionin e kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Vrijimin e marrëdhënieve të punës së znj. {...} në pozicionin ku ajo ka emërimin, atë të sekretares gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
3. Efektet juridike të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, fillojnë pas marrjes formë të prerë të tij.
4. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet znj. {...} dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**